



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2023:071808
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05472179

C.nr.909/23

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Besnik Shala, në çështjen kontestimore të paditësve: F.B, E.B, V.B, S.B, të gjithë nga fshati R...., Komuna e Pejë, të cilët i përfaqëson sipas autorizimit av. B.A nga Peja, kundër të paditurës: KS.P në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 5.000 €, jashtë seancës me dt. 19.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësit F.B, E.B, V.B, S.B, të gjithë nga fshati R...., Komuna e Pejë, kundër të paditurës KS.P në Prishtinë, me objekt kontesti Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 5.000€.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij pranë Gjykatës Themelore në Pejë, kanë ushtruar padi me dt.22.03.2023, kundër të paditurës, me bazë juridike Kompensim Dëmi sipas auto-përgjegjësisë, vlera kontestit 5.000 €.

I autorizuari i paditësve me parashtrësën e datës 07.03.2024, e ka njoftuar gjykatën se e tërheqë padinë ndaj të paditurës, për shkak se me të njëjtën kanë arritur ujdj jashtëgjyqësore, andaj kërkojmë nga gjykata që të lejoj tërheqjen e padisë

Sipas dispozitës së nenit 261.1, LPK-së, e cila parashikon se paditësi mund ta tërheq padinë, pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin, në të cilën i padituri paraqet në gjykatë përgjigje në padi, gjersa paragrafi 2, parashikon se padia mund të tërhiqet edhe më vonë gjerë në përfundim të shqyrtimit kryesor, në çoftë se i padituri e jep pëlqimin për një gjë të tillë. Po që se i padituri brenda afatit prej 7 dite, nga dita e njoftimit për tërheqjen e padisë nuk deklarohet për këtë gjë, do të konsiderohet se e njëjta e ka dhënë pëlqimin për tërheqjen e padisë.

Andaj duke u mbështetur në dispozitën e nenit 261 par. 2, 3, dhe 4 e lidhur me nenin 387 par. 1 pika c) të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Numri i lëndës: 2023:071808
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05472179

GJYKATA THEMELORE PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.909/23 dt. 19.03.2024

Gjyqtari
Besnik Shala

KËSHILLA JURIDIKE

Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa,
Konform nenit 261 pra.4 të LPK-së.